



# Ne jemi

# këtu për ju.

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**

## Marrja e kujdesit shëndetësor

### A është hapur zyra e mjekut tim?

Po. Klinikat e NYC Health + Hospitals janë tani të hapura për vizitat në person dhe për televizita, qoftë përmes telefonit apo videos.

Jo gjithçka ka nevojë për vizita në person. Flisni me ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor për mundësinë e vizitës përmes telefonit apo videos nga shtëpia.

### A është e sigurt ta takoj në person ofruesin tim të kujdesit shëndetësor?

Po. Siguria jote nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme dhe ne jemi duke marrë masa të mëtejshme paraprake për t'u siguruar që pacientët dhe personeli ynë të jenë të sigurt.

- + Të gjithë pacientëve dhe personelit do t'u kontrollohet temperatura kur të hyjnë në ambientet tona
- + Pacientët do të depistohen për simptoma të COVID-19 përpara vizitave dhe në ditën e takimit

- + Maskat janë të nevojshme për të gjithë pacientët, vizitorët dhe personelin
- + Për të moshuarit dhe pacientët vulnerabël do të ofrohen orare të posaçme në qendra të caktuara
- + Hapësirat do të shënohen qartazi për të ndihmuar në ruajtjen e distancimit fizik
- + Sallat e ekzaminimit do të pastrohen shpesh, sidomos midis vizitave të pacientëve
- + Të gjitha zonat e përbashkëta do të pastrohen e dezinfektohen gjatë gjithë ditës
- + Çdo pacient mund të sjellë me vete një asistente shëndetësore sipas nevojës

### A është e sigurt që të vijnë fëmijët e mi në klinikë?

Po. Është veçanërisht e rëndësishme që fëmija të mos i humbasë vizitat e kontrollit për fëmijë apo vaksinat. Asnjë fëmijë nuk duhet t'i mungojë kujdesi i nevojshëm shëndetësor.

Sigurohuni që fëmija të mbajë maskë gjatë vizitave nëse është nga 2 vjeç e lart. Nëse nuk keni vetë maskë, do t'ju japim ne një.

## Si mund të ricaktoj një takim që është anuluar?

Mund të telefononi në nr. 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692) për ta riprogramuar. Nëse keni humbur një depistim parandalues apo takim për sëmundje kronike, si p.sh. diabeti apo hipertensioni, është veçanërisht e rëndësishme të riprogramoni një vizitë me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor. Mos i vononi gjërat.

## Nuk kam një mjekun tim, a pranoni pacientë të rinj?

Po, ne pranojmë pacientë të rinj. Nëse ju duhet të gjeni një mjek, telefononi në nr. 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692) për të programuar takimin tuaj të parë.

## Zyra e mjekut tim primar është e mbyllur. A mund të lë një takim me ju?

Po. Ne jemi këtu për të gjithë njujorkezët. Nëse nuk keni qenë ndonjëherë pranë NYC Health + Hospitals, telefononi në nr. 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692) për të programuar takimin tuaj të parë ose për të gjetur një qendër pranë jush.

## Pagesa për kujdesin shëndetësor

### Kam shqetësime për shpenzimin.

Shpenzimi nuk duhet të bëhet pengesë që të vizitoheni te mjeku. Ne ofrojmë opsione për mbulim kujdesi shëndetësor me kosto të ulët dhe pa kosto për të gjithë njujorkezët.

### E kam humbur mbulimin e sigurimit tim shëndetësor.

Ne mund t'ju ndihmojmë në këto raste. Konsulentët tanë financiarë janë të gatshëm t'ju ndihmojnë të gjeni një plan sigurimesh që është i përshtatshëm për ju dhe familjen tuaj. Telefononi në nr. 1-646-694-3131 për të folur me dikë sot. Nëse nuk kualifikoheni ose nuk e përballoni dot sigurimin, NYC Care ju gjendet pranë. Mësoni më shumë duke telefonuar në nr. 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273).

Telefononi për të lënë një takim  
**1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692)**



**RUANI LIDHJET. NA NDIQNI.**

[nychealthandhospitals.org](http://nychealthandhospitals.org)

## COVID-19

### Më duket se kam COVID-19, duhet të lë një takim?

Nëse keni simptoma të COVID-19 kontaktoni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor përmes MyChart ose duke programuar një vizitë teleshëndetësie.

Mjeku mund t'ju kërkojë të veçoheni siç duhet në shtëpi, të paraqiteni pranë ExpressCare ose në pavijonin e urgjencës, në varësi të simptomave tuaja. Nëse nuk keni se ku të shkoni, mund të përfitonit të drejtën e një dhome hoteli falas.

Të gjithë njujorkezët duhet të kryejnë një analizë diagnostikuese për COVID-19, edhe nëse kanë apo s'kanë simptoma, apo nëse janë a jo në kategori rreziku të lartë. Analizat bëhen shpejt, lehtë e falas. Për të gjetur qendrat e analizave pranë jush, telefononi në nr. 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692).

### A të shkoj për vizitë nëse kam simptoma të COVID-19 apo nëse kam temperaturë mbi 100,4°F?

Nëse keni simptoma të COVID-19, telefononi në nr. 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692) për të sqaruar opsionet e vizitës suaj.

### Nëse më dalin pozitive analizat e COVID-19, a duhet të shkoj në vizitën tim?

Nëse keni COVID-19 duhet të veçoheni siç duhet për të paktën 10 ditë, ku 3 ditët e fundit të kenë qenë pa mjekime, si p.sh. acetaminofen (Tylenol) apo ibuprofen (Motrin, Advil). Nëse nuk keni vend ku të veçoheni siç duhet, mund të përfitonit të drejtën e një dhome të përkohshme hoteli falas.

Nëse e keni kaluar infeksionin e COVID-19, mund të shkoni pa merak në vizitën tuaj klinike.

Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

**NYC  
HEALTH+  
HOSPITALS**